

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3, nenin 104, paragrafi 19, si dhe kapitullin XVIII të Ligjit Nr. 05/L-45 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2019 miratoi:

RREGULLORE PËR LIKUIDIMIN E SIGURUESVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Me këtë rregullore definohej likuidimi i siguruesve si dhe kriteret dhe procedurat e likuidimit të siguruesve në mënyrë që të ruhet stabiliteti financiar në vend dhe të sigurohet mbrojtja adekuate e të drejtave të policëmbajtësve.
2. Kjo rregullore aplikohet për siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në klasat e jetës dhe jo-jetës në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përkufizuara në Ligjin Nr. 05/L-45 për Sigurimet (me tutje Ligji për Sigurimet) dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregullore:
 - 1.1. **Administratori i përkohshëm** - nënkupton një person i emëruar nga BQK-ja me qëllim të menaxhimit të procesit të administrimit të përkohshëm sipas Ligjit për Sigurime;
 - 1.2. **Likuidator** - nënkupton një person të emëruar apo miratuar nga BQK-ja, për të marrë në kontroll të plotë siguruesin, me qëllim menaxhimit të procesit të likuidimit;
 - 1.3. **Likuidim** - nënkupton realizimin e aseteve të një siguruesi dhe shpërndarjen e të ardhurave ndërmjet kreditorëve, aksionarëve ose anëtarëve sipas rastit, që përfshin domosdoshmërisht ndërhyrjen nga BQK-ja, pavarësisht nëse janë vullnetare ose të detyrueshme;
 - 1.4. **Proces i likuidimit** - nënkupton procedurat kolektive që përfshijnë realizimin e likuidimit sipas kësaj rregullore dhe Ligjit për Sigurime.
 - 1.5. **Sigurues** - përveç nëse në mënyre specifike përmenden ndaras në këtë rregullore, termi sigurues nënkupton siguruesin dhe risiguruesin.

Neni 3

Llojet e likuidimit

1. Likuidimi i siguruesit apo degës së siguruesit të jashtëm mund të bëhet në pajtueshmëri me Ligjin për Sigurimet dhe këtë rregullore përmes:
 - 1.1 Likuidimit vullnetar;
 - 1.2 Likuidimit.

Neni 4

Likuidimi vullnetar

1. Likuidimi vullnetar mund të iniciohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të siguruesit. Procedura e likuidimit vullnetar mund të filloj vetëm pasi siguruesi të marr miratimin paraprak nga BQK-ja.
2. Vendimi për likuidim vullnetar mund të miratohet nga BQK-ja në rastet si në vijim:
 - 2.1. Siguruesi, i cili është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullatorë / është solvent, vendos të dalë nga tregu dhe të përfundojë aktivitetet sigurorese për të cilat është licencuar nga BQK-ja.
 - 2.2. Siguruesi i cili është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullatore/është solvent vendos se ka arritur qëllimin e tij si dhe aksionarët e tij vendosin ti kthejnë investimet e tyre të siguruesi përkatës.
3. Likuidimi vullnetar mund të ndodh vetëm nëse siguruesi është në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore për kapital dhe solvencë gjatë procesit të likuidimit; rrjedhimisht i mbulon detyrimet e tij.
4. Për miratimin e likuidimit vullnetar, siguruesi duhet të bëj kërkesë me shkrim në BQK të shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregullore. BQK-ja do të vendos lidhur me kërkesën e siguruesit për likuidim vullnetar, brenda dyzet e pesë (45) ditëve kalendarikë nga data e kompletimit të dokumentacionit.

Neni 5

Kërkesa për miratimin e likuidimit vullnetar

1. Kërkesës për miratim të likuidimit vullnetar nga neni 4 paragrafi 4 të kësaj rregullore, duhet ti bashkëngjitet dokumentacioni si në vijim:
 - 1.1. Vendimi i asamblesë së përgjithshme të aksionarëve për likuidim vullnetar;
 - 1.2. Vendimi për emërimin e likuidatorit të propozuar;
 - 1.3. Plani i likuidimit;
 - 1.4. Vërtetimin e përmbushjes së obligimeve tatimore nga organet kompetente tatimore;
 - 1.5. Informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për miratim të likuidimit vullnetar.
2. Plani i likuidimit sipas paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të këtij neni, duhet të përmbajë së paku si në vijim:

- 2.1. Mënyrën e njoftimit të likuidimit të gjitha palëve të ndërlidhura;
- 2.2. Mënyrën dhe shumën e kompensimit të likuidatorit
- 2.3. Vlerësimin e aseteve gjithsej dhe të ndara sipas klasave, përfshirë asetet monetare, asetet e prekshme dhe të paprekshme afatgjata dhe afatshkurta, asetet financiare si dhe të arkëtueshmet;
- 2.4. Vlerën e detyrimeve gjithsej dhe sipas klasave dhe prioritetit, që rrjedhin nga portofolio e sigurimit si dhe detyrimet tjera;
- 2.5. Plani kohor për shlyerjen e detyrimeve;
- 2.6. Kostoja e likuidimit;
- 2.7. Vlerën e parashikuar të aseteve të siguresit pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve;
- 2.8. Masat ligjore, organizative, financiare, teknike si dhe masat tjera për zbatimin e planit të likuidimit;
- 2.9. Çdo informacion tjetër shtesë të kërkuar nga BQK-ja, rast pas rasti.

Neni 6

Miratimi/refuzimi i likuidimit vullnetar

1. BQK-ja miraton kërkesën për likuidim vullnetar, nëse vlerëson se:
 - 1.1. Interesat e policëmbajtëve dhe kreditorëve tjerë të siguresit mbrohen në mënyrë të duhur;
 - 1.2. Plani i likuidimit është në pajtueshmëri me Ligjin për Sigurime, këtë rregullore si dhe ligjet e rregulloret tjera relevante në fuqi;
 - 1.3. Kërkesa është plotësuar dhe e mbështetur me dokumentacion e kërkuar sipas Ligjit për Sigurime, kësaj rregullore dhe ligjeve e rregulloreve tjera relevante në fuqi;
 - 1.4. Siguruesi është në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore për kapital, solvencë dhe asete në mbulim të provizioneve teknike gjatë procesit të likuidimit, në mënyrë që ti mbuloj detyrimet e tij.
2. BQK-ja refuzon kërkesën për likuidim vullnetar, nëse vlerëson se:
 - 2.1. Interesat e policëmbajtëve dhe kreditorëve tjerë të siguresit nuk mbrohen në mënyrë të duhur;
 - 2.2. Plani i likuidimit nuk përmban elementet nga neni 5 paragrafi 2 të kësaj rregullore;
 - 2.3. Kërkesës nuk i është bashkëngjitur dokumentacioni nga neni 5 i kësaj rregullore;
 - 2.4. Siguruesi nuk është në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore për kapital, solvencë dhe asete në mbulim të provizioneve teknike për zbatimin e procesit të likuidimit vullnetar;
 - 2.5. Asetet e siguresit janë të pamjaftueshme për të mbuluar detyrimet e saj, gjatë procesit të likuidimit.
3. Në rastin e refuzimit të kërkesës për miratim të likuidimit vullnetar, BQK-ja do të kërkoj nga siguruesi që të marr masat e nevojshme që ti eliminoj arsyet për të cilat është bazuar refuzimi ose do të vendos për zbatimin e likuidimit sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimet dhe dispozitat e kësaj rregullore për likuidim.

4. Nëse BQK-ja refuzon kërkesën për miratim të likuidimit vullnetar sepse vlerëson se siguruesi nuk posedon kapital apo menaxhim adekuat, apo se siguruesi nuk to të jetë në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore gjatë procesit të likuidimit vullnetar, dhe një likuidim vullnetar nuk mund të jetë e realizueshëm në mënyrë të rregullt, atëherë BQK do të vendos për zbatimin e likuidimit sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimet dhe dispozitat e kësaj rregullore për likuidim.
5. Nëse BQK-ja vendos për refuzim të kërkesës për likuidim vullnetar dhe vendos për zbatimin e likuidimit, licenca e siguruesit duhet të revokohet në pajtim me nenet 16 dhe 124 të Ligjit për Sigurimet.

Neni 7

Likuidimi

1. BQK-ja mund të nxjerr vendim për të filluar procesin e likuidimit të një siguruesi, në rastet si në vijim:
 - 1.1. Nëse BQK vlerëson se ekziston një apo më shumë arsye të revokimit të licencës së siguruesit sipas nenit 16 dhe 124 të Ligjit për Sigurimet;
 - 1.2. Nëse siguruesi dështon të jetë në pajtueshmëri me kërkesat rregullative për kapital, solvencë dhe asete në mbulim të provizioneve teknike;
 - 1.3. Nëse BQK-ja vlerëson se siguruesi nuk mund të arrijë nivelin e kërkuar të likuiditetit dhe aftësisë paguese gjatë procesit të administrimit të përkohshëm;
 - 1.4. Nëse BQK-ja refuzon kërkesën për miratim të likuidimit vullnetar të siguruesit;
 - 1.5. Nëse BQK-ja vlerëson se siguruesi gjatë procesit të administrimit të përkohshëm nuk përmirësuar për të qenë në pajtim me nenin 99 të Ligjit për sigurime;
 - 1.6. Nëse asambleja e përgjithshme e aksionarëve, e mbajtur sipas kërkesës së administratorit të përkohshëm në pajtim me nenin 98 të Ligjit për Sigurimet, dështon të rrisë kapitalin;
 - 1.7. Përveç rasteve të përmendura më lartë në këtë nen, në rastin e subjektit të varur ose degës së siguruesit të huaj, BQK-ja mund të vendos për të filluar likuidimin e subjektit të varur ose degës nëse autoriteti mbikëqyrës ose organi tjetër kompetent nga vendi amë i siguruesit, ka vendosur likuidimin e siguruesit ose të degëve të atij siguruesi.

Neni 8

Likuidatori

1. Në rastet e likuidimit vullnetar, njëkohësisht me vendimin për fillimin e procesit të likuidimit vullnetar, siguruesi duhet ta caktojë një person si likuidator, i cili duhet të udhëheqë procesin e likuidimit vullnetar.
 - 1.1. Likuidatori i caktuar nga siguruesi, duhet t'i plotësojë të gjitha ato kritere që kërkohen për miratimin e drejtorëve dhe të menaxherëve të lartë të siguruesve, përfshirë kualifikimin dhe përvojën;
 - 1.2. Vendimi për fillimin e procesit të likuidimit vullnetar si dhe caktimin e likuidatorit miratohet nga BQK.
 - 1.3. Në rast të ndryshimit të likuidatorit gjatë procesit të likuidimit vullnetar, siguruesi duhet ta marrë miratimin paraprak nga BQK.

2. Në rastet e likuidimit, njëkohësisht me anë të vendimit për fillimin e procesit të likuidimit BQK-ja do të nxjerr vendim për emërimin e likuidatorit.
3. Vendimi për emërimin e likuidatorit do të përcaktoj detyrat dhe përgjegjësitë e likuidatorit, në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara me nenin 104 të Ligjit për Sigurimet. Ky vendim do të përcaktoj edhe kushtet e pagesës së likuidatorit.
4. Likuidator do të emërohet personi që i plotëson së paku kriteret si në vijim:
 - 4.1. kriteret për miratimin e drejtorëve dhe të menaxherëve të lartë të siguruesve, përfshirë kualifikimin në pajtim me Ligjin për sigurime.
 - 4.2. të ketë përvojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale në fushën financiare apo fusha tjera relevante, ose përvojë në likuidimin e së paku dy subjekteve juridike të madhësisë së ngjashme me siguruesin në likuidim;
 - 4.3. të mos ketë qenë aksionar, anëtar i bordit të drejtorëve ose menaxher i lartë i siguruesit që është subjekt i likuidimit, në tri vitet e fundit para se të merret vendimi për likuidim.
5. BQK-ja mund ta përfundoj mandatin e likuidatorit për arsyet si në vijim:
 - 5.1. nuk vazhdon më tutje të plotësoj kriteret nga paragrafi 4, nënparagrafi 4.1 i këtij neni;
 - 5.2. emërohet likuidator të një sigurues tjetër;
 - 5.3. kryen aktivitetin e likuidimit në mënyrë jo profesionale;
 - 5.4. nuk është në gjendje të kryejë aktivitetet e tij.
6. Në rast të dorëheqjes, likuidatori duhet ta dorëzoj dorëheqjen e tij me shkrim në BQK, duke cekur arsyet e dorëheqjes.
7. Në rastet e ndryshimit të likuidatorit, likuidatori i shkarkuar ose i dorëhequr duhet të vazhdoj aktivitetin e likuidimit deri në emërimin e likuidatorit të ri.

Neni 9

Transferimi i portofolios në proces likuidimi

1. Gjatë procesit të likuidimit të një siguruesi të licencuar për veprimtarinë e sigurimit të jetës, likuidatori i emëruar nga BQK-ja, duhet të bëj përpjekje për të transferuar portofolion e sigurimit te një ose më shumë sigurues tjerë, të licencuar për veprimtarinë e sigurimit jetë.
2. Gjatë procesit të likuidimit të një siguruesi të licencuar për veprimtarinë e sigurimit jo jetë, likuidatori nëse e vlerëson të përshtatshme për policëmbajtësit, mund të bëj përpjekje për të transferuar një pjesë ose gjithë portofolion e sigurimit, te një ose më shumë sigurues tjerë të licencuar për klasat e sigurimit jo jetë. Në raste të tilla siguruesi që e pranon portofolion e sigurimit duhet të jenë të licencuar për klasat e sigurimit jo jetë, portofolion e të cilave e pranon.
3. Transferimi i portofolios nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij mund të bëhet vetëm me miratimin paraprak të BQK-së, sipas përcaktimeve të neneve 36, 37 dhe 38 të Ligjit për Sigurimet.

4. Në rastet e transferimit të portofolios së sigurimeve sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, siguruesi pranues, duhet të jetë në gjendje të mirë financiare (sa i përket kapitalit, solvencës dhe likuiditetit) si dhe pranimi i portofolios së sigurimit nuk do ta përkeqësoj këtë gjendje.
5. Transferimi i portofolios së sigurimit mund të bëhet vetëm brenda afatit tridhjetë (30) ditor nga data e hapjes së likuidimit, pas të cilit afat kontrata e sigurimit duhet të shuhet sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve dhe nenit 10 të kësaj rregullore.
6. Përparësitë në pagesën e kërkesave sipas Ligjit për Sigurimet dhe kësaj rregulloreje, nuk janë të aplikueshme për shpenzimet që bëhen për transferimin e portofolios së sigurimit sipas këtij neni.

Neni 10

Vlefshmëria e kontratave të sigurimit

Në rastet e likuidimit të siguruesve, kontratat për sigurim shuhen pasi të kenë kaluar tridhjetë (30) ditë nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit për hapjen e likuidimit nga BQK-ja.

Neni 11

Njoftimi për likuidimin

1. Likuidatori i emëruar nga BQK-ja, sa më shpejtë që është e mundur por jo më gjatë se brenda dy (2) ditëve të punës nga dita e emërimit, do ta dërgoj një njoftim në të gjitha zyrat e siguruesit, përfshirë zyrat e ndërmjetësuesve të cilat ndërmjetësojnë në llogari të atij siguruesi, ku i njofton për emërimin e tij si likuidator sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimet dhe kohën kur do ti marr përgjegjësitë si likuidator.
2. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përmbaj:
 - 2.1. njoftimin se autorizimet dhe përgjegjësitë e personave të angazhuar lidhur me përgjegjësitë financiare të siguruesi, nga momenti i marrjes së përgjegjësiave nga likuidatori, anulohen.
 - 2.2. njoftimin se personat të cilët më parë kanë pasur autorizime për të dhënë udhëzime në emër të siguruesit, lidhur me pagesat apo transferimin e pasurisë së siguruesit apo për të administruar pasurinë e siguruesit nuk i kanë më ato autorizime.
 - 2.3. njoftimin se personat të cilët më parë kanë pasur autorizime për të dhënë udhëzime në emër të siguruesit, lidhur me pagesat apo transferimin e pasurisë së siguruesit apo për të administruar pasurinë e siguruesit nuk i kanë më ato autorizime;
 - 2.4. njoftimin se licenca e siguruesit është revokuar;
 - 2.5. pasojat ligjore të anulimit të licencës në kontratat ekzistuese të sigurimeve;
 - 2.6. njoftimin se të gjitha pretendimet ndaj siguruesit të shoqëruara me dëshmi përkatëse, duhet ti drejtohen likuidatorit të emëruar, brenda 90 ditëve pas publikimit të fundit në gazetë sipas paragrafit 3 të këtij neni.
 - 2.7. njoftimin për pasojat e mundshme ligjore nëse pretendimet nuk i dërgohen likuidatorit të emëruar brenda afatit.

- 1.1. emrin, mbiemrin dhe të dhënat kontaktuese të likuidatorit dhe emrin dhe adresën se ku duhet të dorëzohen pretendimet ndaj siguruesit.
- 1.2. njoftimin për të drejtat dhe detyrimet e kreditorëve në procesin e likuidimit, në veçanti njoftimi për prioritetin e kërkesave.
2. Likuidatori duhet të publikojë njoftimin, me të cilin saktësohen veprimet e ndërmarra në një ose në më shumë gazeta me qarkullim të gjerë në Kosovë. Publikimi duhet të bëhet jo më rrallë se një herë në javë dhe do të zgjasë një muaj. BQK-ja do të shikojë dhe miratojë përmbajtjen e njoftimit.
3. Njoftimi sipas paragrafit 3 të këtij neni, duhet të publikohet në gjuhët zyrtare të Kosovës, një shpallje në madhësi jo më të vogël se një e teta (1/8) e faqes së gazetës në të cilën publikohet.
4. Në pajtim me nenin 103, paragrafi 2 të ligjit për sigurimet, përmbajtja e njoftimit duhet të miratohet nga BQK-ja.
5. Njoftimi sipas këtij neni duhet të publikohet edhe në web faqen zyrtare të siguruesit që është në proces të likuidimit.

Neni 12

Detyrat dhe përgjegjësitë e likuidatorit dhe efektet e likuidimit

1. Funkcionet kryesore të likuidatorit janë që të administrojë siguruesin në likuidim, ta likuideojë pasurinë e tyre, të paguajë dëmet që u janë shkaktuar poseduesve të policave dhe kreditorëve.
2. Likuidatori i ka të gjitha autorizimet e bordit të drejtorëve dhe aksionarëve të siguruesit në fjalë.
3. Në varësi të qëllimit primar për plotësimin maksimal të detyrimeve të siguruesit ndaj poseduesve të policave dhe kreditorëve, likuidatori e shpejton shitjen e pasurisë së siguruesit dhe pagesat për poseduesit e policave.
4. Likuidatori mund të ndërmarrë çfarëdo veprimi në drejtim të likuidimit të siguruesit.
5. Likuidatori nuk mund të lëshojë polica të reja apo të zgjas afatin e policave ekzistuese.
6. Likuidatori, me miratim me shkrim të BQK-së, mund të marrë hua të garantuar me aktivën e siguruesit ose të pa garantuar.
7. Likuidatori mund të ndalojë ose kufizojë pagesën e çfarëdo detyrimi, të punësojë dhe largojë nga puna punonjësit, menaxherët apo këshilltarët, të ekzekutojë çfarëdo instrumenti në emër të siguruesit apo të iniciojë ose të mbrojë e të ndërmarrë në emër të siguruesit çfarëdo veprimi apo procedure ligjore.
8. Likuidatori ka autorizime të pakufizuara për të hyrë dhe për t'i kontrolluar zyrat, librat e llogarive dhe shënimet tjera, si dhe pasurinë dhe detyrimet tjera të siguruesit.
9. Me kërkesën e likuidatorit, zyrtari i zbatimit të ligjit ose zyrtarët tjerë do ta ndihmojnë likuidatorin që të hyjë në objektet e siguruesit, për t'i kontrolluar asetet e tij.
10. Likuidatori ka të drejtë të paraqesë padi dhe të mbrohet kundër padive në gjykata të rregullta dhe në procedura arbitrazhi, në emër të siguruesit në likuidim.

11. Likuidatori ka të drejta dhe privilegje të njëjta dhe i nënshtrohet detyrimeve, ndëshkimeve, kushteve dhe kufizimeve të njëjta që zbatohen për bordin e drejtorëve apo të punësuarve të tjerë, të një siguruesi të licencuar sipas këtij ligji.
12. Të drejtat e bordit të drejtorëve dhe të aksionarëve të siguruesit suspendohen gjatë likuidimit. Me kompensim të arsyeshëm, likuidatori mund t'i mbajë disa apo të gjithë anëtarët e bordit të drejtorëve dhe punonjësit që janë të nevojshëm për të administruar likuidimin dhe për t'i kryer funksionet, posaçërisht të caktuara me shkrim nga likuidatori.
13. Likuidatori mund t'i largojë nga puna të gjithë punonjësit e siguruesit dhe ata mund të mos marrin kurrfarë kompensimi për shkak të këtij largimi.
14. Likuidatori e siguron pasurinë e siguruesit dhe kërkon mbrojtjen e saj nga vjedhja apo nga ndonjë veprim tjetër i papranueshëm duke ndërmarrë veprime që veçmas përfshijnë:
 - 14.1. ndërrimin e çelësave dhe kufizimin e përdorimit të tyre të hyrjeve të jashtme të zyrave të siguruesve dhe të zyrave të brendshme, ku ka mjete financiare, të dhëna apo pajisje që do t'i mundësonin ndonjë individ të ketë qasje joligjore në mjetet financiare;
 - 14.2. ndërrimin apo krijimin e kodeve në kompjuterët e siguruesit dhe t'i lejohet qasje vetëm një numri të caktuar të punonjësve e të besueshëm;
 - 14.3. lëshimin e kartelave të reja të identifikimit me fotografi për hyrje të të punësuarve të autorizuar në lokalet e siguruesve dhe kontrollit të hyrjes të personave të tjerë në këto lokale;
 - 14.4. anulimin e autorizimeve për personat me përgjegjësi financiare të siguruesit dhe lëshuarjen e autorizimeve të reja dhe njoftimi i palëve të treta për këtë;
 - 14.5. informimin e poseduesve të policave, agjentëve, brokerëve, risiguruesve, zyrave relevante për tatim, bankave dhe bizneseve që kanë raporte afariste me siguruesin, se personat të cilët më parë kanë qenë të autorizuar për të dhënë këshilla në emër të siguruesve lidhur me udhëheqjen e pasurisë dhe llogarive, nuk kanë më autorizime të tilla dhe se vetëm likuidatori dhe individët e autorizuar nga ai kanë një autorizim të tillë, dhe;
 - 14.6. pezullimin e pagesave në përgjithësi me shpërndarje të gjerë dhe të pagesave të çfarëdo lloji për bordin e drejtorëve dhe aksionarët me kusht, që bordit të drejtorëve t'u paguhet rroga bazë për shërbimet e bëra sipas cilësisë së tyre si anëtar të bordit të drejtorëve.
15. Likuidatori do të përgatis një bilanc të ri të gjendjes të siguruesit në likuidim, bazuar në përcaktimin e vlerës së aseteve në likuidim me zvogëlim ekuivalent me vlerën e detyrimeve të siguruesit në likuidim. Detyrimet do të konsiderohen si të pritura për pagesë dhe kamata do të pushojë së rrituri qysh nga dita e emërimit të likuidatorit.
16. Brenda një (1) muaji pas marrjes në posedim të siguruesit, likuidatori bën regjistrimin e të gjitha pasurive të sigurimeve dhe ia dërgon një kopje të atij regjistrimi BQK-së, e cila do t'ia vë në dispozicion një kopje publikut për vlerësim.
17. Pas marrjes në posedim të siguruesit nga Likuidatori:
 - 17.1. çdo afat, çdo çështje statutare, kontraktuese apo tjetër; kërkesat apo të drejtat e siguruesit që skadojnë apo shuhen, do të zgjaten edhe për gjashtë (6) muaj nga dita e skadimit apo e shuarjes;

- 17.2. çdo konfiskim apo kamatë sigurie që ka ndodhur gjashtë (6) muajt e fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit, anulohet dhe asnjë konfiskim apo interes sigurie, përveç atij të krijuar nga likuidatori gjatë zbatimit të këtij neni, nuk mund të konfiskohet nga pasuria e siguruesit nën likuidim, përderisa të zgjasë likuidimi; dhe
- 17.3. shuhen të drejtat e aksionarëve, përveç të drejtës për pranimin e pasurisë nëse mbetet diç pas kryerjes së kënaqshme të kërkesave që kanë përparësi ndaj aksionarëve dhe e drejta për të pranuar çdo pagesë neto të marrë nga të ardhurat e siguruesit dhe kryesisht e gjithë pasuria e tij, nëse likuidatori vërteton se siguruesi ka pasur vlerë neto pozitive në kohën e shitjes.
18. Kërkesat ndaj siguruesit duhet të dorëzohen te likuidatori, brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas shpalljes së fundit në gazetë. Kërkesa që nuk dorëzohet brenda këtij afati kohor mund të merren në konsiderim vetëm pas zgjidhjes së kënaqshme të të gjitha kërkesave të dorëzuara me kohë, dhe vetëm atëherë kur kërkuesi ka dhënë arsytim të mjaftueshëm, lidhur me mos dorëzimin brenda afatit të përcaktuar, përndryshe, kërkesa nuk do të paguhet.
19. Procedurat e përcaktimit të vlefshmërisë, shumës së kërkesave dhe likuidimi i pasurisë së siguruesit dhe pagesa e kërkesave, do të përcaktohet me rregullore nga ana e BQK-së.
20. Shitja e pasurisë duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe komercialisht të arsyeshme.
21. Likuidatori i raporton BQK-së për çdo muaj për mbarëvajtjen e procedurave të likuidimit, në mënyrën siç e përcakton BQK-ja.

Neni 13

Personat profesionistë

1. Likuidatori mundet të angazhojë kontabilistë, aktuarë, vlerësues, avokatë, konsultantë dhe profesionistë tjerë, vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga BQK-ja.
2. Kërkesa për miratim të personave nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të përcaktojë në hollësi nevojën për angazhimin e tyre, kompensimin e propozuar për personat e tillë dhe një vërtetim, që dëshmon të gjitha faktet materiale nëse personi ka lidhje me siguruesin. Personi i angazhuar nuk duhet të ketë lidhje me likuidatorin dhe siguruesin. Para se t'i bëhet çfarëdo pagese një personi të tillë, likuidatori duhet të marrë miratimin me shkrim të BQK-së për shumën e një pagese të tillë.
3. Personat profesioniste nga ky nen duhet në minimum të plotësojnë kriteret për drejtorët dhe menaxherët e lartë të siguruesve, të përcaktuara me ligjin për sigurimet dhe rregulloren për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm. Përveç këtyre kriterëve, të njëjtit duhet të plotësojnë edhe kriteret e përcaktuara ligjore për profesionet e tyre në pajtim me ligjet përkatëse.

Neni 14

Shmangia e transfereve para likuidimit

1. Likuidatori mund të ngritë padi në Gjykatë për të anuluar një transaksion të bazuar në një dokument të falsifikuar apo mashtrues, që siguruesi e ka lëshuar në dëm të poseduesve të policave apo kreditorëve gjatë pesë (5) viteve të fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit.

2. Likuidatori mund të ngritë padi në Gjykatë për të anuluar transaksionet e mëposhtme, të cilat ndikojnë në pasurinë e siguruesit ose për t'i kthyer nga palët e treta, transferet e siguruesit si në vijim:
 - 2.1. transferet dhuruese për çdo person që ka lidhje me siguruesin që janë bërë gjatë pesë (5) viteve të fundit, para hyrjes në fuqi të likuidimit;
 - 2.2. transferet dhuruese palëve të treta brenda pesë (5) viteve të fundit, para hyrjes në fuqi të likuidimit;
 - 2.3. transaksionet, në të cilat dëmshpërblimi i dhënë nga siguruesi ka tejkaluar dukshëm vlerësimin real, që është kryer gjatë tri (3) viteve të fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit;
 - 2.4. çdo veprim i bërë me qëllimin të të gjitha palëve të implikuara, që të fshehet pasuria nga poseduesit e policave apo nga kreditorët ose të dobësohen të drejtat e tyre gjatë pesë (5) viteve të fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit;
 - 2.5. krijimi i së drejtës së pengmarrjes, ose ndonjë huaje në pasurinë e siguruesit pa miratimin paraprak të BQK-së; dhe
 - 2.6. nëse gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të fundit para hyrjes në fuqi të likuidimit, siguruesi ka bërë transfere të pasurisë ose parasë së gatshme në emër të një borxhi për ndonjë kreditor, dhe ky transfer ka ndikuar që ai kreditor të përfitoj më shumë sesa që do të përfitonte në rast se pagesa do të ishte bërë pas likuidimit, me kusht që anulimi nga ky nën paragraf të mos zbatohet në transferet e kryera për policëmbajtësit që rrjedhin nga policat e tyre të sigurimit.
3. Likuidatori mund të ngritë padi në gjykatë për të anuluar transaksionet me personat e lidhur me siguruesin që janë bërë brenda një viti para hyrjes në fuqi të likuidimit, nëse transaksionet e tilla kanë qenë të dëmshme për interesat e pronarëve të policave të sigurimit dhe të kreditorëve të tjerë. Veprimin për anulimin e transaksioneve (transfereve) të tilla, mund ta bëjë likuidatori brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të likuidimit.
4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të parashtruara në këtë nen, likuidatori nuk mund të anulojë një pagesë apo transfer të siguruesit, nëse është bërë në rrjedha të zakonshme të afarizmit, apo nëse kjo ka qenë pjesë e këmbimit të njëkohshëm për një vlerë të arsyeshme ekuivalente, ose në atë masë që pas transferit marrësi i ka ofruar një kredi të pasiguruar siguruesit, e cila nuk është përmbushur nga siguruesi, deri në datën e hyrjes në fuqi të likuidimit.
5. Likuidatori mund të kthejë pasurinë ose vlerën e pasurisë së transferuar të siguruesit nga një përfitues i transferit fillestar, vetëm nëse pranuesi i transferit fillestar nuk e ka paguar vlerën reale të pronës dhe e ka ditur se transferi fillestar ka mundur të pezullohej sipas dispozitave të këtij ligji.
6. Qiradhënësi i zyrave të siguruesit dhe/apo kryesit e shërbimeve publike, siç është për shembull rryma, gasi natyral, uji, shërbimi telefonik nuk mund t'ia ndërpresin shërbimet e tilla siguruesit vetëm për shkak të likuidimit apo për shkak se siguruesi nuk i ka paguar ato shërbime para likuidimit. Pavarësisht nga ky kufizim, një qiradhënës i tillë apo kryes i shërbimeve publike, mund të kërkojë që likuidatori të deponojë një depozitë sigurie në ndonjë bankë, si kusht për qiradhënësin dhe kompaninë e shërbimeve publike për të vazhduar detyrimin e kryerjes së shërbimeve publike, gjatë procedurave të likuidimit. Shuma maksimale e një depozite të tillë, nuk mund të jetë më e madhe se çmimi i shërbimeve të kryera për siguruesin gjatë muajit të fundit, para se të fillojë likuidimi.

Neni 15

Përparësitë në pagesën e kërkesave

1. Në çdo likuidim të pasurisë së siguresit, kërkesat e lejuara dhe të siguruara paguhen nga fitimi i pasurisë garantuese ose përndryshe pasuria e garantuesit i dërgohet kreditorit të siguresit. Çfarëdo shume e një kërkesë të lejuar e të siguar që mbetet pasi pengu të jetë shpenzuar, trajtohet si kërkesë e siguar.
2. Kërkesat tjera të lejuara paguhen për të gjitha borxhet tjera sipas përparësive të përshkruara më poshtë:
 - 2.1. shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të shkaktuara nga likuidatori dhe BQK-ja, duke përfshirë pagesat e profesionisteve gjatë zbatimit të dispozitave juridike për likuidimin;
 - 2.2. pagat e arsyeshme dhe beneficionet e sigurimit social për punonjësit jo-menaxherial të siguresit në likuidim;
 - 2.3. kërkesat e ligjshme të papaguara për policat e sigurimit;
 - 2.4. tatimet dhe detyrimet e mbetura brenda një (1) viti para fillimit të likuidimit; dhe
 - 2.5. kreditorët tjerë dhe shumat e pasiguruara të kërkesave të siguruara.
3. Përmbushja e kërkesave që i takojnë një klase të mëvonshme, me prioritet më të ulët, mund të iniciohet vetëm pas përmbushjes complete dhe të plotë të kërkesave të klasës paraprake me prioritet më të lartë.
4. Nëse shumat në dispozicion për pagesë, për çfarëdo klase të kërkesave është e pamjaftueshme për të bërë pagesën e plotë, kërkesat e tilla zvogëlohen në përmasa proporcionale.
5. Çfarëdo përfitimesh që mbesin pas pagimit të kërkesave të poseduesve të policave të sigurimit dhe kreditorëve të tjerë, ndahen mes aksionarëve ose pronarëve të siguresit, në përputhje me të drejtat e tyre.

Neni 16

Vlefshmëria e kërkesës për pagesë

1. Kërkesa për pagesë për të qenë e vlefshme duhet ti dorëzohet likuidatorit dhe plotësojë këto kriteret:
 - 1.1 Të paraqitet brenda afatit të përcaktuar sipas nenit 103 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Ligjit për Sigurimet;
 - 1.2 Natyra dhe vlera e kërkesës korrespondon me regjistrat e siguresit në likuidim, nëse janë të disponueshëm.
2. Nëse kërkesa nuk mund të faktohet nga regjistrat e siguresit, ose nëse regjistrat që i dispononin siguresi janë jo adekuate për të përcaktuar vlefshmërinë e kërkesës, likuidatori do të kërkojë nga paraqitësi i kërkesës që brenda një periudhe të caktuar kohore, të paraqet të dhëna që provojnë se kërkesa duhet të paguhet nga siguresi.
3. Likuidatori, mund të vendosë për vlefshmërinë e çdo kërkesë për të cilën konsideron se është paraqitur dhe dorëzuar në mënyrë të arsyeshme.

Neni 17

Forma dhe përmbajtja e kërkesës për pagesë

1. Kërkesa për pagesë duhet të bëhet në forme të shkruar dhe duhet të përmbaje, së paku elementet si në vijim:
 - 1.1. Vlera dhe detajet e kërkesës;
 - 1.2. Të dhëna nëse kërkesa është e siguruar ose e pasiguruar. Nëse është e siguruar, të dhëna për instrumentin dhe vlerën me të cilin është siguruar kërkesa.
 - 1.3. Të dhëna nëse janë bërë pagesa nga siguruesi në lidhje me atë kërkesë.
 - 1.4. Të dhëna që argumentojnë se siguruesi është përgjegjës për pagesën e vlerës së kërkuar.
 - 1.5. Të dhëna se nuk ka marrëveshje për kompensim (offset), të aplikueshme për kërkesën në fjalë.
 - 1.6. Të dhëna tjera që mund të kërkojë likuidatori, me pëlqimin e BQK-së.

Neni 18

Paraqitja e kërkesave që nuk i'u është përcaktuar vlera

1. Kërkesat që nuk i'u është përcaktuar vlera, duhet të paraqitet te likuidatori, brenda afatit sipas nenit 103 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Ligjit për Sigurimet, në formën sipas nenit 17 të kësaj rregullore.
2. Kërkesat e palëve të treta, të pazgjidhura deri në kohën kur ka filluar procesi i likuidimit, duhet të paraqiten si kërkesa që janë pranuar por që nuk është përcaktuar vlera.
3. Pagesat e kërkesave të pranuar por që nuk është caktuar vlera, nuk mund të bëhet derisa natyra dhe vlera e kërkesave janë përcaktuar si dhe janë klasifikuar sipas prioriteteve të pagesave në pajtim me nenin 107 të Ligjit për Sigurimet dhe këtë rregullore.

Neni 19

Kërkesa të vlefshme pa paraqitjen e tyre

1. Kërkesat e mëposhtme konsiderohen të vlefshme dhe të pagueshme sipas prioriteteve të pagesave në pajtim me nenin 107 të Ligjit për Sigurimet dhe këtë rregullore, edhe nëse të njëjtat nuk paraqiten sipas dispozitave të kësaj Rregullore:
 - 1.1. Pjesa e papaguar e benefiteve të policave për të cilat siguruesi ka nisur pagesat para datës së fillimit të likuidimit.
 - 1.2. Kërkesat e kompletuara të cilat siguruesi i ka pranuar para datës së fillimit të likuidimit.
 - 1.3. Kërkesat që rrjedhin nga primet e pafituara.
 - 1.4. Kërkesat që rrjedhin nga institucione përgjegjëse për tatime, brenda një viti para se të filloj procesi i likuidimit.
 - 1.5. Ndonjë kërkesë tjetër që BQK-ja mund ta përcaktoj, të ngjashme me kërkesat nga nën paragrafët 1.1. deri 1.3. të këtij neni.

Neni 20

Përcaktimi i vlerës së kërkesave të siguruara

1. Përcaktimi i vlerës së kërkesave të siguruara duhet të bazohet në udhëzimet e mëposhtme:
 - 1.1. Vlera e kërkesës së siguar nuk mund të jetë më e lartë se vlera e instrumentit të siguar (kolaterali).
 - 1.2. Kërkuesi i siguar mund ta dorëzoj instrumentin e sigurisë (kolateralin) te likuidatori, ku kërkuesi i siguar ka te drejtën e pagesës së barabarte me vlerën e instrumentit të sigurisë ose vlerën e kërkesës cilado që është me e vogël. Një vlerësues i emëruar nga likuidatori dhe i miratuar nga BQK-ja do të përcaktoj vlerën e instrumentit të sigurisë (kolateralit).
 - 1.3. Përlllogaritja e interesit për një kërkesë të siguar, ndalohet që nga data e fillimit të likuidimit.

Neni 21

Përcaktimi i vlerës së kërkesave të mbetura për klasat e sigurimeve jo jetë

1. Kërkesat e ligjshme të mbetura që rrjedhin nga policat e sigurimeve jo jetë, përbëhen nga pretendimet e mëposhtme dhe për shumat e tilla sikurse përcaktohet në udhëzimet në vijim:
 - 1.1. Për kërkesat për dëmet e ndodhura dhe të rregulluara (vlerësuara) para datës së fillimit të likuidimit, dhe për të cilët pagesa periodike është në fuqi në atë datë, vlera e kërkesës do të përcaktohet sipas kalkulimit aktuaristik, ose vlera e diskontuar e të gjitha pagesave të papaguara periodike, sipas metodave që BQK-ja i përcakton si të arsyeshme.
 - 1.2. Për kërkesat për dëmet e ndodhura dhe të rregulluara para datës të fillimit të likuidimit, por të papaguara deri me atë datë, vlera e kërkesës duhet jetë e barabartë me vlerën e vendosur gjatë rregullimit (vlerësimit) para fillimit të procesit të likuidimit.
 - 1.3. Për kërkesat për dëmet e ndodhura nga fillimi i likuidimit, por të cilat ende nuk janë raportuar (IBNR), vlerën e kërkesës për raste të tilla, do ta përcaktoj vlerësuesi i emëruar nga likuidatori dhe i miratuar nga BQK-ja.
 - 1.4. Nëse me kushte të policës është paraparë e drejta e kthimit të primit, në raste të tilla polica konsiderohet e anuluar nga data e fillimit të likuidimit. Vlera e kërkesës bëhet për vlerën e paskaduar të primit të përcaktuar sipas formulës (ang) “short period scale” të miratuar nga siguruesi.
 - 1.5. Primi i pafitur, nëse me kushte të policës është përcaktuara se polica vlen nga një datë e caktuar deri në një datë tjetër të caktuar dhe mund të shkëputet nga secila palë brenda kohës së vlefshmërisë së policës. Në raste të tilla, vlera e kërkesës është pjesa e primit të paguar por të pafitur.
 - 1.6. Në të gjitha rastet tjera, vlera më e mirë e mundshme që mund të përcaktohet.

Neni 22

Përcaktimi i vlerës së kërkesave të mbetura për klasat e sigurimeve jetë

1. Kërkesat e ligjshme për policat e sigurimit nga sigurimet jetë, përbëhen nga pretendimet e mëposhtme dhe për shumat e tilla sikurse përcaktohet me udhëzimet në vijim:

- 1.1. Përfitimet e maturuara para ose në datën e fillimit të likuidimit, për të cilën pagesat periodike janë në fuqi që nga ajo datë. Vlera e kërkesës përcaktohet përmes kalkulimit aktuaristik ose vlera e diskontuar e të gjitha pagesave të papaguara periodike të ardhshme, sipas këtyre metodave që BQK-ja i përcakton të arsyeshme.
- 1.2. Vdekja ose përfitimet e maturuara të ndodhura para datës së fillimit të likuidimit, por pagesa e të cilave nuk është përcaktuar ose bërë nga deri në këtë datë. Vlera e kërkesës duhet të jete e barabarte me vlerën e përfitimit.
- 1.3. Në vlerësimin e përfitimeve nga polica e sigurimit jetë të cilat janë në fuqi deri në datën e fillimit të likuidimit, likuidatori do ta emëroj një aktuar të pavarur, i cili duhet të miratohet nga BQK-ja. Aktuari do ta përcaktoj vlerën që pasqyron beneficionet nga policat e zbatueshme. Aktuari do të përcaktoj vlerat veçmas për të gjitha policat në fuqi bazuar në metoda dhe supozime të miratuara nga BQK-ja. Vlerësimi i bërë nga aktuari sipas këtij nënparagrafi, paraqet vlerën e përfitimeve nga polica e sigurimit.

Neni 23

Përcaktimi i vlerës së kërkesave tjera

1. Likuidatori do të përcaktoj vlerat e të gjitha kërkesave tjera në pajtim me udhëzimet si më poshtë:
 - 1.1. Të gjitha kërkesat që rrjedhin nga kontratat ose obligimet për të cilat siguruesi paguan interesa, qira, dividendë ose ngarkesa (tarifa) fikse, do të vlerësohen në vlerën e principalit dhe interesin deri në datën e fillimit të likuidimit. Të gjitha interesat, qiratë, dividendat dhe ngarkesat (tarifat) fikse nuk vazhdojnë të llogariten pas datës së fillimit të likuidimit.
 - 1.2. Obligimet ndaj risiguruesit (tjera nga obligimet e siguruara me fonde të mbajtura nga siguruesi), agjentet dhe brokerët, konsiderohen obligime të pasigurura të siguruesit.
 - 1.3. Vlerat e kërkesave sipas këtij neni do të përcaktohen nga likuidatori duke marrë parasysh vlefshmërinë e tyre, në pajtim me kërkesat e kësaj rregullore. Vlera e kërkesës do të bazohet nga të dhënat e siguruesit dhe ose nga të dhënat dhe dëshmitë e paraqitësit të kërkesës. Në të gjitha rastet tjera vlera caktohet sipas vlerësimit të arsyeshëm të likuidatorit.

Neni 24

Njoftimi i autoriteteve tjera rregullatore

1. BQK-ja para se të marrë vendim për likuidimin e subjektit të varur apo degës së siguruesit të vendit të huaj, njofton autoritetin mbikëqyrës përkatës të vendit të huaj dhe siguruesin e vendit të huaj.
2. Në rastet kur vendi i origjinës së subjektit të varur apo degës së siguruesit të huaj është anëtar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), njoftimi nga paragrafi 1 do t'i dërgohet edhe këtij autoriteti.
3. Njoftimi për vendimin për likuidim do të përfshijë, por pa u kufizuar në, pasojat ligjore të likuidimit.
4. Përgjashtimisht nga përcaktimi i paragrafit 1 të këtij neni, në rastet kur për shkak të ruajtjes së interesave të të siguruarve nuk është i mundur njoftimi paraprak për hapjen e procedurave të likuidimit, BQK-ja

njofton autoritetin mbikëqyrës të vendit të huaj dhe siguruesin e vendit të huaj subjekti i varur apo dega e të cilit është subjekt i procesit të likuidimit, brenda 7 ditëve kalendarike pas marrjes së vendimit për likuidim.

Neni 25

Dispozitat tjera të likuidimit

1. Punonjësve dhe personave profesionalë të emëruar për të përfaqësuar ose ndihmuar likuidatorin ose BQK-në lidhur me likuidimin, nuk mund t'u paguhen shuma më të mëdha se ato që u paguhen punonjësve ose agjentëve të siguruesve për shërbimet e ngjashme në Kosovë, përveç nëse BQK-ja mund të lejojë pagesa më të larta, nëse vlerëson se pagesa më të larta nevojiten për rekrutimin dhe mbajtjen e kuadrit të nevojshëm dhe profesionist.
2. BQK-ja ka autorizime të merr vendim për kompensimin e likuidatorëve dhe agjentëve të tyre për veprimet e tyre, në kushtet të cilat BQK-ja i konsideron të përshtatshme.

Neni 26

Raportimi në BQK

1. Likuidatori gjatë procesit të likuidimit vullnetar duhet të raportoj në BQK së paku një herë në muaj apo sipas kërkesës së BQK-së, deri në përfundimin e procesit të likuidimit.
2. Likuidatori i siguruesit në baza të rregullta sipas kërkesës së BQK-së dorëzon në BQK sipas ligjit për sigurime:
 - 2.1. Pasqyrat financiare, së bashku me sqarimet për pozicionet kryesore të pasqyrave financiare:
 - 2.1.1. Pasqyrën e pozicionit financiar;
 - 2.1.2. Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;
 - 2.1.3. Pasqyrën mbi rrjedhën e parasë se gatshme;
 - 2.1.4. Pasqyrën mbi planifikimin e fluksit monetar;
 - 2.1.5. Raport mbi diversifikimin e mjeteve nëpër banka, përfshirë konfirmimin e bankës mbi gjendjen e mjeteve në llogari si dhe konfirmimin për personat e autorizuar të llogarive;
 - 2.1.6. Raportin e likuiditetit;
 - 2.1.7. Raport mbi gjendjen e dëmeve pezull, përfshirë demet në procese gjyqësore;
 - 2.1.8. Raport mbi demet e paguara (lista e personave të kompensuar):
 - 2.1.9. Lista e personave të kompensuar dhe shuma e kompensimit;
 - 2.1.10. Dëmet e zgjidhura me ujdj jashtëgjyqësore;
 - 2.1.11. Dëmet në procese gjyqësore;
 - 2.1.12. Raport mbi gjendjen e llogarive të pagueshme;
 - 2.1.13. Raportin mbi gjendjen e pronave – pronave investuese;

2.1.14. Raporti mbi gjendjen e llogarive të arkëtueshme dhe statusin e arkëtimit të tyre.

2.1.15. Pasqyrat e audituara financiare dhe opinionin e auditorit të jashtëm.

Neni 27

Raportimi përfundimtar në BQK

1. Pasi të jetë bërë shitja e pasurisë së siguruesit, likuidatori i paraqet një raport përmbledhës BQK-së, i cili duhet të përfshijë bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe burimet e të ardhurave që janë përdorur gjatë procesit të likuidimit. Raporti gjithashtu duhet të përmbaj të dhëna për kërkesat e paguara dhe kërkesat e papaguara nëse ekzistojnë. Raporti nga ky paragraf duhet të mbahet në dosjen e siguruesit të likuiduar në BQK.
2. Pas miratimit nga BQK-ja të raportit sipas paragrafit 1 të këtij neni, BQK-ja dhe likuidatori lirohen nga çfarëdo përgjegjësie tjetër në lidhje me likuidimin e siguruesit.
3. Në fund të procesit të likuidimit vullnetar, likuidatori do ta dorëzoj një raport përmbledhës në BQK, për gjithë procesin e likuidimit. Ky raport duhet të përmbaj, bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe burimet e të ardhurave që janë përdorur gjatë procesit të likuidimit si dhe konfirmimin nga likuidatori për pagesën e të gjitha kërkesave të kreditorëve. Raporti nga ky paragraf duhet të mbahet në dosjen e siguruesit të likuiduar në BQK.

Neni 28

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregullore nga ana e likuidatorit, do të jetë subjekt i masave ndëshkuese administrative, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Sigurimet.

Neni 29

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulli 30 mbi Validitetin dhe Shumën e Aksionarëve dhe Dëmeve të Kreditorëve, në Likuidim e datës 28 mars 2002.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës